



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____, datë _____

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E QENDRËS
SË BOTIMEVE ZYRTARE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i të drejtave, detyrave dhe përgjegjësiive të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe të institucioneve të përfshira në procesin e botimit të akteve, si dhe i procedurës për botimin e “Fletorez zyrtare” të Republikës së Shqipërisë dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik.
2. “Fletorja zyrtare” e Republikës së Shqipërisë është i vetmi botim zyrtar në Republikën e Shqipërisë, ku botohen aktet juridike, botimi i të cilave është i detyrueshëm në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 2 Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të botimit të “Fletores zyrtare” dhe Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, si dhe garantimin e mirëfunksionimit të arkivit elektronik të akteve.

Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohen:

1. **“Akte të botueshme”**, të gjitha aktet, botimi i të cilave është i detyrueshëm në bazë të legjislacionit në fuqi.
2. **“Akt i përditësuar”**, akti që pasqyron të gjitha ndryshimet, që ka pësuar akti origjinal, në një tekst të vetëm integral dhe që pasqyron variantin në fuqi të tij.
3. **“Botimi në arkivin elektronik të akteve”**, përfshin:
 - a) botimin e “Fletores zyrtare” në formatin elektronik;
 - b) botimin e akteve;
 - c) botimin e ndryshimeve të akteve;
 - ç) aktet e përditësuara.
4. **“Botimi në “Fletoren zyrtare”**”, bërja e njohur në mënyrë botore, në formë të shkruar dhe elektronike, e akteve të botueshme sipas legjislacionit në fuqi.
5. **“Botimi në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare”**, bërja e njohur në mënyrë botore, në formë të shkruar dhe elektronike, e të gjitha njoftimeve të institucioneve shtetërore, të cilat lidhen me procedurat e ndërmarra prej tyre dhe që duhen të bëhen publike.
6. **“Buletini i Njoftimeve Zyrtare”**, formati i botimit zyrtar, i cili përmban të gjitha njoftimet e institucioneve shtetërore me qëllim bërjen e tyre publike.
7. **“Faqja elektronike e Qendrës së Botimeve Zyrtare”**, faqja elektronike në internet, në të cilën botohen të gjitha aktet juridike të nxjerra nga institucionet e Republikës së Shqipërisë.

8. **“Fletore zyrtare” e Republikës së Shqipërisë**, është i vetmi botim zyrtar në Republikën e Shqipërisë ku publikohen aktet juridike të institucioneve të Republikës së Shqipërisë, botimi i të cilave parashikohet në Kushtetutë ose në legjislacionin në fuqi.
9. **“Indeksi i “Fletores zyrtare”**”, listimi kronologjik i të gjitha akteve juridike të botuara në “Fletoren zyrtare”, në serinë e fletoreve zyrtare të një viti.
10. **“Përditësim”**, procesi i pasqyrimin të ndryshimeve të aktit në tekstin bazë të tij.
11. **“Qendra e Botimeve Zyrtare”**, institucioni përgjegjës për botimin e “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare.

KREU II QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE

Neni 4 Statusi i Qendrës së Botimeve Zyrtare

1. Qendra e Botimeve Zyrtare është person juridik publik, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Drejtori dhe nëpunësit e Qendrës së Botimeve Zyrtare kanë statusin e nëpunësit civil, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil. Për punonjësit administrativë, marrëdhënia e punës rregullohet nga Kodi i Punës.
3. Struktura dhe organika e Qendrës së Botimeve Zyrtare miratohet nga Kryeministri, me propozimin e ministrit të Drejtësisë.
4. Rregulla të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare përcaktohen me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 5 Përgjegjësitë e Qendrës së Botimeve Zyrtare

1. Qendra e Botimeve Zyrtare është përgjegjëse për:
 - a) botimin e akteve të botueshme, të cilat dërgohen në këtë Qendër;
 - b) botimin në formë të shtypur të kodeve të përditësuara dhe të përmbledhësve të legjislacionit sipas tematikës;

- c) mbajtjen dhe mospublikimin e të dhënave, të ligjeve dhe akteve të tjera të botueshme, deri sa ato të botohen në “Fletoren zyrtare” apo Buletinin e Njoftimeve Zyrtare;
 - ç) redaktimin teknik të versioneve përfundimtare, të cilat botohen në “Fletoren zyrtare” apo Buletinin e Njoftimeve Zyrtare;
 - d) sigurimin e botimit të saktë dhe në kohë të akteve në “Fletoren zyrtare” apo Buletinin e Njoftimeve Zyrtare;
 - dh) bashkërendimin e punëve me operatorin ekonomik i cili bën shpërndarjen e “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
 - e) bashkëpunimin me institucionet kompetente shtetërore për sigurimin e faqes zyrtare të internetit nga keqpërdoruesit e mundshëm dhe mirëmbajtjen e saj;
 - ë) ribotimin e “Fletores zyrtare” apo të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare për numrat që u janë ezauruar kopjet e botuara dhe botimin me kërkesë.
2. Për botimin në formë elektronike të “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, Qendra e Botimeve Zyrtare është përgjegjëse për:
- a) publikimin dhe garantimin e origjinalitetit të “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
 - b) zbatimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të informacionit, duke prodhuar botimin elektronik të “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
 - c) përmirësimin e sistemit në përputhje me zhvillimet e ardhshme teknike;
 - ç) zbatimin dhe zgjerimin e objekteve teknike për të siguruar qasjen për të gjithë përdoruesit në botimin elektronik të “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
 - d) vendosjen e rregullave të brendshme për ngritjen e sigurisë dhe qasjen në lidhje me sistemin e informacionit në prodhimin e botimit elektronik të “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
 - dh) ruajtjen e përhershme të 2 (dy) kopjeve fizike dhe elektronike të çdo numri të “Fletores zyrtare” dhe të Buletinit të Njoftimeve Zyrtare;
 - e) arkivimin e dokumenteve të parashikuara në shkronjën “dh”, të kësaj pike, dhe trajtimin e tyre në përputhje me zhvillimet e ardhshme teknologjike.
3. “Fletorja zyrtare” dërgohet për botim me miratimin dhe nën përgjegjësinë e drejtorit të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe, në mungesë të tij, nga nëpunësi i deleguar prej tij.

4. Buletini i Njoftimeve Zyrtare dërgohet për botim me miratimin dhe nën përgjegjësinë e drejtorit të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe, në mungesë të tij, nga nëpunësi i deleguar prej tij.
5. Buletini i Njoftimeve Zyrtare botohet sa herë të jetë e nevojshme, por jo më pak se një herë në javë. Formati, kriteret teknike, procedurat e përgatitjes, ditët e botimit, tirazhi i kopjeve, mënyra e vënies në qarkullim dhe shpërndarja e Buletinit të Njoftimeve Zyrtare përcaktohen me udhëzim të Këshillit të Ministrave.
6. Qendra e Botimeve Zyrtare është përgjegjëse për përgatitjen e raportit vjetor të punës dhe prezantimin e këtij raporti përpara ministrit të Drejtësisë brenda muajit janar të çdo viti kalendarik. Një kopje e raportit i dërgohet Kryeministrit.

KREU III
BOTIMI NË “FLETOREN ZYRTARE” DHE NË BULETININ E
NJOFTIMEVE ZYRTARE

Neni 6
Fletorja zyrtare

1. “Fletorja zyrtare” është dokumenti zyrtar, në formatin e shtypur dhe elektronik, në të cilin gjendet i pasqyruar teksti i aktit të botueshëm në versionin përfundimtar të tij, pas procedurës së miratimit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi.
2. Në “Fletoren zyrtare” botohen:
 - a) ligjet;
 - b) dekretet e Presidentit të Republikës së Shqipërisë;
 - c) aktet normative të Këshillit të Ministrave;
 - ç) aktet normative të ministrave dhe drejtuesve të institucioneve qendrore;
 - d) vendimet, rezolutat dhe deklaratat e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;
 - dh) vendimet e Gjykatës Kushtetuese;
 - e) vendimet për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, të cilat botohen në numrin më të parë të “Fletores zyrtare”;
 - ë) të gjitha aktet e tjera, botimi i të cilave është i detyrueshëm sipas legjislacionit në fuqi;
 - f) indeksi vjetor i “Fletores zyrtare”.

3. “Fletorja zyrtare” botohet në formë të shtypur nga Qendra e Botimeve Zyrtare në atë sasi që përkon me nevojat dhe kërkesat për përfitimin e këtij shërbimi nga abonentët.
4. Botimi i “Fletores zyrtare” në formë të shtypur dhe në formë elektronike nga kushdo tjetër është i ndaluar. Të gjithë shfrytëzuesit e materialeve të “Fletores zyrtare” duhet të përmendin numrin dhe vitin e botimit të “Fletores zyrtare”.

Neni 7

Kriteret teknike të botimit të “Fletores zyrtare” në formatin letër

1. “Fletorja zyrtare” botohet në format A4, bardh e zi, letër 80 gr/m² mat pa lustër.
2. Lidhja bëhet me qepje me tel për një numër faqesh deri në 80 dhe me ngjitje për numër faqesh më shumë se 80.
3. “Fletorja zyrtare” përmban:
 - a) emërtimin “Fletorja zyrtare e Republikës së Shqipërisë”;
 - b) numrin rendor;
 - c) datën e botimit (ditën, muajin dhe vitin e botimit);
 - ç) vendin e botimit.
4. Emërtimi, viti i botimit dhe numri i “Fletores zyrtare” duhet të shënohen qartë në të gjitha faqet e “Fletores zyrtare”.
5. Format i “Fletores zyrtare” është sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 8

Dërgimi i akteve për botim

1. Aktet e botueshme të parashikuara në nenin 6, të këtij ligji, publikohen në “Fletoren zyrtare”, vetëm atëherë kur versioni përfundimtar në origjinal i aktit është nënshkruar nga organi që e ka nxjerrë atë dhe me kërkesën e tij.
2. Teksti i akteve të botueshme në “Fletoren zyrtare” i dërgohet Qendrës së Botimeve Zyrtare në formatin e shkruar në letër dhe në formatin elektronik nga institucionet shtetërore përkatëse që kanë miratuar aktin.

3. Në rastin e dërgimit për botim të ligjeve, akti i botueshëm dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 (pesë) ditëve nga njoftimi i dekretit të Presidentit për shpalljen e ligjit, por, në çdo rast, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e dekretit.
4. Nëse Presidenti e kthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend dhe dekreti i tij e humbet fuqinë, akti i botueshëm dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 (pesë) ditëve nga data e votimit kundër tij prej shumicës të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
5. Nëse Presidenti nuk ushtron të drejtën e parashikuar në pikën 1, të nenit 84, dhe në pikën 1, të nenit 85, të Kushtetutës, akti i botueshëm dërgohet për botim nga Kuvendi brenda 5 (pesë) ditëve nga kalimi i afatit kushtetues për shpalljen ose kthimin për rishqyrtim të ligjit. Në këtë rast, Kuvendi shënon edhe datën e dërgimit të ligjit të miratuar te Presidenti i Republikës.
6. Në rastin e dërgimit për botim të ligjeve, të miratuara sipas procedurës së përcaktuar në pikën 4, të nenit 84, të Kushtetutës, Kuvendi e dërgon aktin e botueshëm menjëherë. Ky ligj botohet në numrin më të parë të “Fletores zyrtare”.
7. Institucioni shtetëror, që dërgon aktin e botueshëm, kujdeset që formati elektronik të nënshkruhet elektronikisht, sipas legjislacionit në fuqi. Të dyja formatet kanë vlerë të njëjtë juridike. Në rast mospërputhjeje të të dyja formateve, Qendra e Botimeve Zyrtare i kërkon institucionit të konfirmojë përmbajtjen e saktë të aktit të botueshëm dhe, vetëm pas përgjigjes zyrtare të institucionit dërgues, vijon me botimin e aktit.
8. Këshilli i Ministrave përcakton me udhëzim mënyrën, format dhe procedurën e dërgimit të tekstit të akteve të botueshme në “Fletoren zyrtare”, si dhe formatin e shkruar në letër dhe formatin elektronik të tyre.

Neni 9

Detyrimet e institucioneve të cilat i publikojnë aktet e tyre në “Fletoren zyrtare”

1. Dërgimi i akteve të botueshme të nxjerra nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë për publikim në “Fletoren zyrtare” bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i Presidencës apo personi i deleguar prej tij.

2. Dërgimi i ligjeve dhe i akteve të tjera të botueshme të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për publikim në “Fletoren zyrtare” bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit apo personi i deleguar prej tij.
3. Dërgimi i akteve të botueshme të Këshillit të Ministrave për publikim në “Fletoren zyrtare” bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo personi i deleguar prej tij.
4. Dërgimi i akteve të botueshme të ministrive për publikim në “Fletoren zyrtare” bëhet nga sekretari i Përgjithshëm i ministrisë apo personi i deleguar prej tij.
5. Dërgimi i akteve të tjera të botueshme për publikim në “Fletoren zyrtare” bëhet nga titullari i institucionit, organit apo organizatës që ka nxjerrë aktin.
6. Titullari i institucionit është përgjegjës për dërgimin e aktit përfundimtar për publikim në “Fletoren zyrtare”.
7. Detyrimet e përcaktuara në këtë dispozitë zbatohen dhe për dërgimin e njoftimeve që do të botohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.
8. Parashikimet aktuale në aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me botimin në median kombëtare, zëvendësohen me botimin në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

Neni 10 **Afati i botimit**

1. Afati i botimit të akteve të botueshme është jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e ardhjes së aktit për botim.
2. Në rast të masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevoje dhe urgjence, institucioni i interesuar bën kërkesë të arsyetuar për botimin sa më parë të një akti në numrin më të parë të “Fletores zyrtare” të radhës.

Neni 11 **Botimi**

1. “Fletorja zyrtare” dhe Buletini i Njoftimeve Zyrtare në formë elektronike publikohen në të njëjtën ditë kur janë publikur edhe në formën e tyre të shtypur.

2. Botimi në formë elektronike i “Fletores zyrtare” dhe Buletinit të Njoftimeve Zyrtare duhet të përmbajë edhe informacion në lidhje me datën dhe orën e publikimit. Momenti i daljes së “Fletores zyrtare” nga botimi konsiderohet data dhe ora e përfshirjes në arkivin elektronik të akteve.
3. Pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, çdo subjekt mund të njihet, drejtpërdrejt dhe pa shpërblim, me përmbajtjen e akteve të botuara.

Neni 12

Regjistri shtetëror i akteve

Qendra e Botimeve Zyrtare administron regjistrin elektronik dhe shkresor të akteve, ku pasqyrohen të gjitha të dhënat e detyrueshme për botimin, numërtimin, korrektimet gjuhësore e juridike, shënimet në rubrika të veçanta për shfuqizimet, ndryshimet ose shtesat pas miratimit të aktit. Modeli i regjistrit elektronik dhe shkresor miratohet me urdhër të ministrit të Drejtësisë.

Neni 13

Detyrimi për bashkëpunim

Institucionet shtetërore kanë detyrimin të bashkëpunojnë me Qendrën e Botimeve Zyrtare, duke i siguruar të gjithë informacionin që ajo kërkon në përmbushje të detyrave të saj.

KREU IV

ARKIVI ELEKTRONIK I AKTEVE DHE NJOFTIMEVE

Neni 14

Arkivi elektronik i akteve

1. Qendra e Botimeve Zyrtare kujdeset për funksionimin e arkivit elektronik të akteve.
2. Arkivi elektronik i akteve është baza elektronike e të dhënave, që përmbledh të gjitha fletoret zyrtare në formatin elektronik dhe të gjitha aktet e botuara.
3. Arkivi elektronik i akteve është lehtësisht i përdorshëm dhe me aksesim të plotë nga publiku, në rrugë elektronike. Konsultimi i tij është pa pagesë.
4. Në arkivin elektronik të akteve botohen të gjitha aktet e botueshme, së

bashku me të gjitha ndryshimet e pësuara pas miratimit të tyre. Kur akti i botuar pëson ndryshime pas miratimit, Qendra e Botimeve Zyrtare, gjatë botimit të aktit ndryshues në arkivin elektronik të akteve përditëson aktin bazë me këto ndryshime. Në arkivin elektronik të akteve botohet, në çdo rast, akti i përditësuar.

5. Arkivi elektronik i akteve përmban një rubrikë të posaçme, ku pasqyrohen të gjitha aktet e botueshme, të cilat dalin në bazë dhe për zbatim të një akti tjetër të botueshëm.

Neni 15

Administrimi i arkivit elektronik të akteve

1. Arkivi elektronik i akteve administrohet nga Qendra e Botimeve Zyrtare, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Ministri i Drejtësisë, në përputhje me standardet, rregullat dhe procedurat e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore, i propozon Këshillit të Ministrave miratimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të arkivit elektronik të akteve.
2. Dhënës të informacionit në arkivin elektronik të akteve janë të gjitha institucionet shtetërore që miratojnë aktet e botueshme.
3. Kur nuk është i mundur realizimi i botimit elektronik të “Fletore zyrtare” për shkak të një mosfunksionimi të paparashikuar dhe të jashtëzakonshëm të sistemit informativ të Qendrës së Botimeve Zyrtare, kjo e fundit merr masat e menjëhershme për rivendosjen e lidhjes sa më shpejt të jetë e mundur.
4. Kur është i nevojshëm publikimi i “Fletore zyrtare” dhe sistemi informativ i Qendrës së Botimeve Zyrtare nuk është funksional, vetëm botimi i shtypur i “Fletore zyrtare” është autentik dhe prodhon efekte juridike.
5. Pas rikuperimit të sistemit të informacionit të Qendrës së Botimeve Zyrtare, versioni përkatës elektronik i edicionit të shtypur, të përmendur në pikën 4, do të vihet pa vonesë në dispozicion për publikun në faqen zyrtare të internetit.
6. Pas rikuperimit të sistemit informativ të Qendrës së Botimeve Zyrtare, faqja zyrtare do të ofrojë informata për të gjitha botimet e shtypura që

janë autentike dhe që prodhojnë efekte juridike në përputhje me pikën 4, të këtij neni.

KREU V BUXHETI DHE ANKESAT

Neni 16 Buxheti

1. Qendra e Botimeve Zyrtare financohet nga buxheti i shtetit dhe buxheti i saj miratohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Drejtësisë.
2. Qendra e Botimeve Zyrtare siguron burime financiare edhe nëpërmjet donacioneve të ndryshme nga donatorë, vendas e të huaj, ose nga çdo burim tjetër i ligjshëm.
3. Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme, që i vijnë Qendrës së Botimeve Zyrtare, përdoren sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.
4. Përcaktimi i çmimeve dhe i tarifave të shërbimeve, si dhe lista e institucioneve që përfitojnë falas kopje të botuara të “Fletore zyrtare” bëhet me urdhër të ministrit të Drejtësisë dhe të ministrit të Financave, me propozimin e drejtorit të Qendrës së Botimeve Zyrtare.
5. Fletoret Zyrtare, pas kalimit të 3 (tri) viteve nga dita e botimit, shpërndahen falas sipas listës që depozitojnë institucionet qendrore për institucionet e tyre të varësisë.
6. Pas kalimit të 5 (pesë) viteve nga dita e botimit të tyre, ato shpërndahen falas në institucionet shtetërore të pushtetit qendror dhe vendor si dhe në fakultetet juridike, publike dhe private.

Neni 17 Ankesat

1. Qendra e Botimeve Zyrtare pranon ankesat lidhur me gabimet dhe defektet që kanë të bëjnë me publikimin e akteve juridike në “Fletoren zyrtare” dhe të njoftimeve në Buletinin e Njoftimeve Publike në formë të shtypur apo në formë elektronike.
2. Afatet dhe masat që duhet të merren në lidhje me ankesat për gabimet dhe

defektet e publikimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 18 Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve të parashikuara në pikën 5, të nenit 5, pikën 8, të nenit 8, pikën 1, të nenit 15, dhe pikën 2, të nenit 17, të këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë, që, brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet e parashikuara në pikën 4, të nenit 4, në nenin 12 dhe në pikën 4, të nenit 16, të këtij ligji.

Neni 19 Shfuqizime

Ligji nr.96/2012, “Për Qendrën e Botimeve Zyrtare”, si dhe çdo dispozitë tjetër nënligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 20 Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

ILIR META